



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 46

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 4 prill 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 182, datë 16.2.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, të ndryshuar..... 2673
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 45, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit”..... 2674
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sh.a..... 2675
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2018..... 2675
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022)..... 2676
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me fuqi të instaluar 1970 kw..... 2677
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.... 2678
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 7.3.2018	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të saj pranë “Raiffeisen Bank” sh.a..... 2679

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 7.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 91, datë 26.9.2011.....	2680
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 7.3.2018	Mbi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sonne” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw.....	2681
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 7.3.2018	Mbi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues 1998 kw.....	2683
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 9.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Draftkontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.....	2684
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 9.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit e shërbimit universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.....	2685
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 12.3.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	2686

**UDHËZIM****Nr. 182, datë 16.2.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 21.5.2015,
“MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE,
PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË
VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR
DETAR PËR AUTOMJETE DHE/OSE
UDHËTARË DHE SHKAQET E
PROCEDURAT E PEZULLIMIT
APO REVOKIMIT TË TYRE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”; të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta; të ligjit nr. 9852, datë 26.12.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në memorandumun e mirëkuptimit për kontrollin shtetëror portual”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, të ndryshuar të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 “Përkufizimi”, pas pikës 13 shtohen pikat 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

“14. “Kontrolli Shtetëror i Flamurit (KSHF)” është strukturë në përbërje të administratës detare dhe ushtron veprimtarinë për inspektimin e certifikimin e sigurisë teknike të mjeteve lundruese, që mbajnë flamurin shqiptar;

15. “Kontrolli Shtetëror Portual (KSHP)” është strukturë e veçantë, që funksionon në

kapitenarinë e porteve për kontrollin shtetëror portual në mjetet lundruese të huaja.”.

Neni 2

Në nenin 9, “Vërtetimi për kushtet teknike të anijes”, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Inspektimet do të kryhen nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit, në përputhje me ligjin nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë” dhe Kontrolli Shtetëror Portual, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 11.1.2017, “Për miratimin e rregullores për kontrollin shtetëror portual në Republikës së Shqipërisë”. Inspektimi do të kryhet në rastin e parë që anija prek portin/terminalin portual dhe do të zgjasë jo më shumë se pesë ditë pa ndërprerë operimin e mjetit lundrues.”.

Neni 3

Në nenin 10, “Kontrata me portin/terminalin portual”, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Te paragrafi i parë, fjala “Pas ...” zëvendësohet me fjalën “Para ...”.

2. Te pika 3, pas fjalëve “operimit të ...”, fjalët “mjetit lundrues” zëvendësohen me fjalët “mjetit/mjeteve lundrues/lundruese”.

3. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Deklarimin e operatorëve për respektimin e orareve në nisje/mbërritje nga/në portet nga mjeti/mjetet lundrues/lundruese objekt licencimi, si dhe të përgjegjësive monetare ndaj udhëtarëve/transportuesve për vonesa të pajustificuara nga autoritetet shtetërore, si policia kufitare dhe migracionit, shërbimi doganor dhe kapitenaria e portit.”.

Neni 4

Në nenin 11, “Prekjet e anijes në port”, pika 2, pika 3 dhe pika 4, ndryshohen si më poshtë:

“2. Gjatë hartimit të grafikut nga porti/terminali portual duhet të mbahen parasysh që prekjet të shpërndahen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët dhe në mënyrë proporcionale gjatë gjithë muajit. Grafiku dhe çdo ndryshim i tij është pjesë përbërëse e dokumentacionit për miratimin e licencës së



transportit ndërkombëtar detar të mallrave dhe të njerëzve dhe që miratohet nga organet përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

3. Operatorët të cilët operojnë në linjë ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse, sipas grafikut të miratuar për linjë, çdo ditë të javës, duhet ta prekin atë port minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) herë në muaj. Ndërsa operatorët të cilët operojnë në linjat ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse sipas grafikut të miratuar për linjë, 5 (pesë) herë në javë e më pak, duhet ta prekin atë port minimalisht 4 (katër) herë në muaj.

4. Në rastet kur operatori i licencuar kërkon të kryejë riparim të anijes, duhet të jetë i pajisur me një leje të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.”.

Neni 5

Në nenin 14, “Transporti detar turistik”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Mjetet e përfshira në licencën për kryerjen e transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe ose udhëtarë nuk mund të kryejnë udhëtime turistike pa zbatuar grafikun e miratuar ose pa u zëvendësuar me mjet tjetër.”.

Neni 6

Udhëzimi nr. 6251, datë 23.12.2016, “Për ndryshimin e udhëzimit nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, shfuqizohet.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjicknuri**

VENDIM

Nr. 45, datë 7.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR KUSHTET E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT DHE KUSHTET KONTRAKTORE TË FURNIZIMIT”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 19, pika 1, germa “F” dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit”,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 87 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE përcakton kushtet e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit”.

2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, furnizimi si mundësi e fundit do të kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit për aq sa është e zbatueshme.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi

**VENDIM****Nr. 46, datë 7.3.2018**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
PAJTUESHMËRISË SË OST SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 54, pika 6 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, nenit 19, pika 1, germa “F”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, ka miratuar certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.

- Në vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, të bordit të ERE-s, është parashikuar që Programi i Pajtueshmërisë duhet t'i dorëzohet autoritetit rregullator ERE, jo më vonë se 6 muaj pas caktimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Ndërkohë që Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të caktohet jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të vendimit final të certifikimit.

- Me vendimin nr. 147, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s ka vendosur për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të propozuar nga OST sh.a.

- Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë OST sh.a., me vendimin nr. 2, datë 21.1.2018, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 962 prot., datë 31.1.2018, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Ky Program ka si qëllim të sigurojë:
- Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OST-së;
- Të shmangë sjelljet diskriminuese të OST-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike (këtu dhe më poshtë – “pjesëmarrësit”) dhe përdoruesve të rrjetit;
- Prezantimin e një mekanizmi për zbatimin e këtij Programi dhe përcaktimi i detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST-së në lidhje me këtë Program;
- Prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM**Nr. 47, datë 7.3.2018**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE TË SHOQËRISË OSHEE
SHA PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të neneve 16; 20, gjerat “a” dhe “e” dhe nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 9 dhe 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me fillimin



e procedurës për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2018,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 808 prot., datë 15.1.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s Planin e Përditësuar të Investimeve për vitin 2018.

- Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2018, të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a., duke konstatuar se plani i investimeve për vitin 2018:

- Paraqitet i ndarë sipas kategorive dhe zërave të shoqëruar me vlerat përkatëse financiare, si dhe një relacion të përgjithshëm teknik për investimet që priten të realizohen gjatë vitit 2018.

- Përmirëson shërbimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes.

- Bazuar në relacionin e dërguar nga OSHEE sh.a. do të ketë impakt në uljen e humbjeve teknike edhe joteknike.

- Ndikon në mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuara dhe në Kodin e Shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Plotëson dhe përmirëson sistemin e matjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Parashikon periudha kohore të zbatimit të investimit për ndërtimet apo rehabilitimet e investimeve përkatëse.

- Mbetet problematik zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve, i cili duhet të shoqërohet me:

- informacion lidhur me kapitalizimin e investimeve të realizuara 2017;

- informacion të plotë lidhur me investimet e realizuara nëpërmjet partneritetit publik privat, kontratat dhe detyrim/realizimet;

- informacion mbi financimin dhe burimin e këtyre financimeve për realizimin e planit të investimeve për vitin 2018, si dhe periudhat e shlyerjes së këtyre investimeve;

- planifikimet e investimeve për të parandaluar problematikat e evidentuara, si në rastin e N/St Ballsh dhe prodhuesve të lidhur në N/St Lozhan;

- miratimin e Këshillit Mbikëqyrës për planin e investimeve për vitin 2018.

- Në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka detyrimin të miratojë planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, i cili përcillet në ERE për miratim, pas hartimit, nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2018.

2. OSHEE sh.a. të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas konstatimeve në këtë vendim.

3. Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 48, datë 7.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN 5-VJEÇARE (2018 - 2022)

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “a” dhe “e” dhe nenit 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 9 dhe 10 të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022),

konstatoi se:



- Me shkresën me nr. 808 prot., datë 15.1.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022).

- Grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2018, të Kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a., duke konstatuar se plani i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022):

- Paraqitet i ndarë sipas kategorive dhe zërave të shoqëruar me vlerat përkatëse financiare për investimet që priten të realizohen gjatë periudhës 5-vjeçare (2018-2022).

- Përmirëson shërbimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes.

- Bazuar në relacionin e dërguar nga OSHEE sh.a. do të ketë impakt në uljen e humbjeve teknike edhe joteknike.

- Ndikon në mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuara dhe në Kodin e Shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Plotëson dhe përmirëson sistemin e matjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Parashikon periudha kohore të zbatimit të investimit për ndërtimet apo rehabilitimet e investimeve përkatëse.

- Mbetet problematik zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve, i cili duhet të shoqërohet me:

- informacion të plotë lidhur me investimet e realizuara nëpërmjet partneritetit publik privat, kontratat dhe detyrim/realizimet;

- informacion mbi financimin dhe burimin e këtyre financimeve për realizimin e planit të investimeve për periudhën 5-vjeçare (2018-2022), si dhe periudhat e shlyerjes së këtyre investimeve;

- miratimin e Këshillit Mbikëqyrës për planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022).

- Në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka detyrimin të miratojë planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, për pesë vitet e ardhshme kalendarike, i cili përcillet në ERE për miratim, pas hartimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Planit e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022)”.

2. OSHEE sh.a. të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas konstatimeve në këtë vendim.

3. OSHEE sh.a. duhet të paraqesë të përditësuar planin e investimeve konform nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 49, datë 7.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VOSKOPOJË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1970 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në



aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Voskopojë” me fuqi të instaluar 1970 kw, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me fuqi të instaluar 1970 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 50, datë 7.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përparësuar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën datë 31.1.2018, protokolluar në ERE me nr. 137 prot., datë 31.1.2018, ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.



Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me nenin 9, pika 3, germa “c”, dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 51, datë 7.3.2018

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLABINJE” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ PRANË “RAIFFEISEN BANK” SHA

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 20, pika “a”, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; në zbatim të nenit 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; të pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të

Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 28.9.2017, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrike Slabinje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve, për garantimin e detyrimeve të kredisë që kjo shoqëri ka ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

- ERE, nëpërmjet shkresës me nr. 233/3 prot., datë 5.10.2017, ka njoftuar shoqërinë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të munguar, të konstatuar në vendimin nr. 151, datë 28.9.2017.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën nr. 180 prot., datë 31.10.2017, ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën nr. 186 prot., datë 24.12.2017, kërkoi nga ERE shtyrjen e afatit të mbledhjes së bordit deri në miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të transferimit të aseteve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën me nr. 192 prot., datë 22.2.2018, ka përcjellë në ERE shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 45/3 prot., datë 20.2.2018, ku miratohet transferimi i aksioneve ose i aseteve pjesë të kapitalit.

- Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. për lënien peng të aseteve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a. (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

Lista e aseteve të luajshme dhe të paluajshme të lëna peng në favor të “Raffaisen Bank” sh.a., nga shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k.

1	Turbinat e ujit dhe pajisjet e shpërndarjes dhe instalimit	copë 10
2	Sistemi i kontrollit dhe pjesët përbërëse	copë 4
3	Sistemi i komandimit, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 2
4	Paneli i frenimit, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 1
5	Pajisje e impulsit KL-46, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 3
6	Valvul 700KD41H-25VK	copë 1
7	Komutator i tensionit të lartë, 6 njësi me pjesët përbërëse	copë 5
8	Valvul 900KD41H-25VK, 2 njësi me pjesët përbërëse	copë 2
9	Kabllo e tensionit të lartë 900 m,	copë 3
10	Kabllo e tensionit të ulët 18620m,	copë 9
11	Gjenerator SFW4300-8/2150, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 8
12	Gjenerator SFW2400-6/1430, 2 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 5
13	Transformator S9-160, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 1
14	Transformator S6300-121, 2 njësi me pjesët përbërëse	copë 9
15	Transformator s3200-110, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 10
16	Turbinat e ujit dhe pajisjet e shpërndarjes dhe të instalimit	copë 11
17	Pajisje 100 kV, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 5
18	Vinç, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 12
19	Fiber optike 24200 M dhe pjesët përbërëse	copë 12

VENDIM

Nr. 52, datë 7.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “ERALD ENERGJITIK” SHPK, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 91, DATË 26.9.2011

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; të nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të neneve 5, germa “a” dhe 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 58, datë 18.4.2017, pika 6.1, germa “a” e kushteve për “Licencën e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e nr. 99, datë 17.6.2016 të bordit të ERE-s, si dhe të nenit 19 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., me nr. 162, seria PV11K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 26.9.2011,

konstatoi se:

- Subjekti tregtar “Erald Energjitik” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 26.9.2011, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Shemri” dhe “Mgullë”, me licencën nr. 162, seria PV11K.

- “Erald Energjitik” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 200 prot., datë 23.2.2018, për aprovimin e ndarjes së shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., në dy shoqëri, shoqërinë “Erald 2 Energy” sh.p.k. dhe shoqërinë “Leadd Energy” sh.p.k.



- ERE nuk është organi kompetent që miraton ndarjen e shoqërive tregtare.

- Në datën 16.2.2018, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe shoqërisë koncesionare “Erald Energjitik” sh.p.k., është lidhur një kontratë shtesë koncesioni me nr. 254 rep. dhe 132/3 kol., “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet METE-s dhe bashkimit të shoqërive “Oberaldi” sh.p.k. dhe “Lala” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Shëmri” dhe “Mgullë”. Në këtë “Shtesë kontrate të koncesionit”, palët bien dakord si më poshtë:

1. Autoritet kontraktues është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Koncesionar për HEC “Mgullë”, me fuqi të instaluar 280 kw dhe prodhim mesatar të energjisë elektrike rreth 1.365.077 kwh, është shoqëria “Leadd Energy” sh.p.k.

3. Koncesionar për HEC “Shëmri”, me fuqi të instaluar 800 kw dhe prodhim mesatar të energjisë elektrike rreth 3.502.000 kwh, është shoqëria “Erald 2 Energy” sh.p.k.

- Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka njohur dhe ka pranuar me nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit, ku në cilësinë e koncesionarit, nuk do të jetë më bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Oberaldi” sh.p.k. dhe “Lala” sh.p.k., por shoqëritë “Leadd Energy” sh.p.k. dhe “Erald 2 Energy” sh.p.k. Në këto kushte, licenca e shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., e humbet qëllimin për të cilin është lëshuar dhe duhet t’i hiqet mbajtësit. Si e tillë, ERE-s në zbatim të legjislacionit në fuqi i lind detyrimi të fillojë procedurën për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k.

- “Erald Energjitik” sh.p.k. nuk do të ushtrojë më aktivitetin për të cilin është licencuar, por ia ka transferuar këtë të drejtë me miratimin e autoritetit kontraktor (MIE) (referuar kontratës shtesë të koncesionit), dy subjekteve të reja tregtare pritëse shoqërisë koncesionare “Erald 2 Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë nga HEC “Shëmri” sh.p.k. dhe shoqërisë koncesionare “Leadd Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë nga HEC “Mgullë”.

- Shoqëria koncesionare “Erald 2 Energy” sh.p.k., autorizuar për prodhimin e energjisë nga HEC “Shëmri”, me fuqi të instaluar 280 kw dhe shoqëria koncesionare “Leadd Energy” sh.p.k., autorizuar për prodhimin e energjisë nga HEC “Mgullë”, me fuqi të instaluar 800 kw, nuk kanë nevojë të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike mbështetur në neni 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., me nr. 162, seria PV11K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 26.9.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Shëmri” dhe “Mgullë”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë shoqërinë “Erald Energjitik” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 53, datë 7.3.2018

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “SONNE” SHPK, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E PRODIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK TOPOJË, ME FUQI TË INSTALUAR 1998 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 8; të nenit 10, pika 2 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e



energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, shoqërisë “Sonne” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 3 prot., datë 1.2.2018, protokolluar në ERE me nr. 149 prot., datë 2.2.2018, shoqëria “Sonne” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë.

- Shoqëria “Sonne” sh.p.k., ka paraqitur autorizim paraprak me afat 6 muaj me nr. 4867/6 prot., datë 27.10.2016, që i është bashkëlidhur dokumentacionit të studimit të fizibilitetit.

- Autorizim me nr. 4867/6 prot., datë 27.10.2016, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk i përket subjektit që ka aplikuar për licencë shoqërisë, “Sonne” sh.p.k., por shoqërisë “Albanian General Elektrisity” sh.p.k.

- Në bazë të nenit 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, theksohet se akti administrativ i cili i jep mbajtësit të saj të drejtën për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, miratohet nga ministri, për objektet deri në 2 mw, ndërsa mbi 2 mw, nga Këshilli i Ministrave.

- Shoqëria “Sonne” sh.p.k. nuk ka depozituar pranë ERE-s një kontratë të lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe miratimin përfundimtar të ndërtimit.

- Aplikimi i shoqërisë “Sonne” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a” dhe “b”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për Impiantin Fotovoltaik (neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, germat “a”, “b”, “d”, pika 4.4.4, germat “a”, “b”, “d”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 9, pika 2, germa “P” (marrëveshje ose autorizimi nga KM-ja); germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti);

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe germa “d” (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s, e kryer pjesërisht);

- Neni 9, pika 4.4.3, germa “c” (shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria); pika 4.4.4, germa “c” (oponencia teknike e projektit); germa “e” (miratimi i zbatimit të projektit nga MIE) dhe pika 4.4.5 (leje nga institucione të tjera),

do të njoftohet subjekti që në zbatim të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sonne” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw.

2. Nëse shoqëria “Sonne” sh.p.k. paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.



3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 54, datë 7.3.2018

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “AED SOLAR” SHPK, PËR
LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA IMPIANTI
FOTOVOLTAIK TOPOJË, ME
KAPACITET PRODHUES 1998 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të neni 5, pika 1, germa “a”; të nenit 8; të nenit 10, pika 2 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 3 prot., datë 1.2.2018, shoqëria “AED Solar” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, Bashkia Fier, me kapacitet prodhues 1998 kw.

- Autorizimi me nr. 4867/6 prot., datë 27.10.2016, i lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i paraqitur në ERE nga subjekti “AED Solar” sh.p.k., nuk i përket kësaj shoqërie por shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k.

- Rezulton se aplikuesi, shoqëria “AED Solar” sh.p.k. nuk ka autorizim të vlefshëm për këtë aplikim, sipas nenit 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”.

- Në bazë të nenit 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, theksohet se akti administrativ i cili i jep mbajtësit të saj të drejtën për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, miratohet nga ministri, për objektet deri në 2 mw, ndërsa mbi 2 mw, nga Këshilli i Ministrave.

- Aplikimi i shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “b”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për Impiantin Fotovoltaik (neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “d”; pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “d”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim datë 20.12.2017, lëshuar nga Gjykata Penale e Shkallës së Parë Tiranë, për përfshirje ose jo në një proces



penal); germa “f” (marrëveshje ose autorizimi nga KM-ja); germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti);

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe germa “d” (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s), e kryer pjesërisht;

- Neni 9, pika 4.4.3, germa “c” (shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria); pika 4.4.4, germa “c” (oponenca teknike e projektit); germa “e” (miratimi i zbatimit të projektit nga MIE) dhe pika 4.4.5 (leje nga institucione të tjera),

do të njoftohet subjekti që në zbatim të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw.

2. Nëse shoqëria “AED Solar” paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 56, datë 9.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “DRAFTKONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES, PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 23.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, për fillimin e procedurës për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, ka përcjellë në ERE “Draftkontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

- Kontrata për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën



kohore 1.1.2018–31.12.2018 rezulton e panënshkruar nga të dyja palët.

- Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017, përcaktohet se kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.

- Në datën 7.3.2018, u depozitua në ERE shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 1017/3, datë 7.3.2018 dhe nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018 të ERE-s.

- KESH sh.a. bën me dije se pavarësisht diskutimeve për të arritur në një draft të dakordësuar të kësaj kontrate, ka pasur dispozita të saj të cilat nuk kanë gjetur dakordësinë e palëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 57, datë 9.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFTKONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SHA, PËR PERIUDHËN 1.1.2018–31.12.2018

Në mbështetje të nenit 16; 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 5 dhe 14, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a., për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018,

konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017.

- ERE, me shkresën nr. 186/4 prot., datë 2.3.2018, u ka kërkuar shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. të bëjnë me dije ERE-n mbi



dispozitat në draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, për të cilat nuk gjejnë dakordësinë respektivisht të dyja kompanitë dhe ka kërkuar dhënien e argumenteve ligjore përkatëse.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në vijim, ka përcjellë në ERE shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, me anë të së cilës kërkon fillimin e menjëhershëm të procedurës për të konkluduar me nënshkrimin e kësaj draftkontrate, e cila do të zgjidhte mosmarrëveshjet e krijuara mes dy shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a., në shkresën e saj shprehet se pavarësisht korrespondencave të vazhdueshme me KESH sh.a. mbeten akoma të pazgjidhura pikat kyçe të saj që kanë të bëjnë me nominimet dhe penaltitetet dhe, konkretisht, neni 4, “Të drejtat dhe detyrimet e blerësit”, neni 5, “Të drejtat dhe detyrimet e shitësit” dhe neni 9, “Zhdëmtimet/kompensimet”.

- KESH sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018, ka përcjellë në ERE draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 58, datë 12.3.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “WIND POWER ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe të neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 164 prot., datë 7.2.2018, ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE, me vendimin nr. 39, datë 23.2.2018, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Wind Power Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë